



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



---

## KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 45 paragrafi 4, neni 46 paragrafi 2, i Ligjit Nr.03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Br.27/2008", neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen XII-të të mbajtur me datën 18.12.2024, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

### VENDIM

#### Neni 1

**MIRATOHET** Granti i Performances Komunale për vitin fiskal 2025.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është përmbledhja e rezultateve për grantin e performances komunale – 2025.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Dragashit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

**KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH**

01 Nr. 06/01-31085-7124

Dt. 18.12.2024



Kryesuesja e Kuvendit  
Arijeta Skeraj

*A. Skeraj*